



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 436/15 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

**VENDIM**  
**Nr.198, datë 23.12.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 72, DATË 31.05.2019, NË**  
**INSTITUCIONIN DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSËS SË PASURISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 72, datë 31.05.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin nr. 35, datë 19.04.2019, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 72, datë 31.05.2019, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatoj se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, për njësinë përgjegjëse, DAP, unifikimin e kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë, *(në rastin konkret për pozicionet e punës “Drejtor Drejtorie”)* në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatoj se, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 10078/1 prot., datë 31.05.2019, me objekt: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, protokolluar pranë Komisionerit me nr.436/13 prot., datë 17.06.2019, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, për unifikimin e kategorizimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, konkretisht për pozicionet “Drejtor Drejtorie”, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, në zbatim të detyrës së lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr.3965/1 prot., datë 10.07.2019, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 426/15 prot., datë 12.07.2019, ka sqaruar se, në kuadër të projektit IPA 2014, “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”, DAP në bashkëpunim me grupin e ekspertëve të projektit, prej muajit tetor 2018, ka filluar punën për zbatimin e këtij projekti, ku dy ndër aktivitetet kryesore të tij, lidhen me, zhvillimin e sistemit të ri të pagave të nëpunësve civilë dhe reformimin e sistemit të pagave të administratës publike në tërësi, si dhe rishikimin e metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës dhe përshkrimeve të punës, hartimin e një katalogu të pozicioneve të punës, etj.

Më tej, në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë për njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, në lidhje me 5 nëpunësit civilë në periudhë prove, që në zbatim në nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të caktojë nëpunësin në kujdesin e të cilit do të kryejnë detyrat këta punonjës.

Sa i takon zbatimin të kësaj detyre, rezulton se, njësia e burimeve njerëzore në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, ka ndjekur të gjithë procedurën ligjore dhe nënligjore të kërkuar, për trajtimin e nëpunësve civilë në periudhë në provë.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimi të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 72, datë 31.05.2019, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 72, datë 31.05.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**